

# AKTIVITETET KRYESORE TË ADMINISTRATËS DOGANORE SHQIPTARE

## I Gusht 2022 I

### Performanca e të ardhurave doganore-Gusht 2022

Administrata Doganore në muajin Gusht 2022 realizoi të ardhurat me shifrën rekord prej 21,3 mld lekësh ose rreth 500 mln lekë më shumë se plani I ndryshuar, dhe krahasuar me Gusht 2021 janë realizuar rreth 4mld lekë më shumë (17,3 mld lekë)

Si 8- mujor janë realizuar rreth 144 mld lekë nga 143,3 mld lekë të planifikuara (me planin e ri të ndryshuar me rritje në Gusht 2022)

Në krahasim me 8-mujorin 2021 janë realizuar rreth 24,8 mld lekë më shumë (rreth 240 mln\$ më shumë)

Një record është realizuar për periudhën 8- mujore edhe me zhdoganimin e artikullit Cigare, e cila ka arritur sasinë prej 2,015 ton në konsum, sasia më e lartë prej vitit 2015

Gjithashtu në total si 8-mujor janë konsumuar rreth 384 mijë ton karburant

**21,3mld  
lekë**

Të ardhura nga dogana për gushtin rekord historik i të ardhurave nga dogana në një muaj

**+ 500mln  
lekë**

Më shumë arkëtime doganore krahasuar me gushtin 2021. Rritja e konsumit të produkteve të akcizës është faktori kryesor

### Dogana online

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të dixhitalizuar shërbimet online për qytetarët dhe bizneset nëpërmjet platformës E- albania .

Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit.

Këto shërbime kanë krijuar lehtësira për biznesin dhe qytetarët nëpërmjet ofrimit të shërbimit në kohë dhe me cilësi, duke shmangur vonesat dhe burokracitë e panevojshme.

Vetëm gjatë muajit Gusht nga DPD janë miratuar 402 shërbime online, ndërkohë që janë në proces 132 aplikime të tjera.



### Barometri i Ballkanit: Shqipëria, me procedurat më të shpejta doganore të import-eksporteve

“Balkan Barometer Business Opinion 2022”, realizuar nga Regional Cooperation Council(RCC) me financimin e Bashkimit Evropian (BE) vlerëson progresin e procedurave në shërbim të biznesit të Doganave Shqiptare.


Edicioni 2022 i Barometrit të Ballkanit- Regional Cooperation Council i Balkan Barometer Business Opinion 2022 (rcc.int), vlerëson perceptimet e biznesit nëpërmjet një pyetësori me 177 pyetje drejtuar 1203 përfaqësuesve të biznesit, edhe sa i përket procedurave doganore për importet dhe eksportet.

Sipas Barometrit, “në rajon Shqipëria duket që ka procedurat më të shpejta doganore të importeve në dogana me më pak se dy ditë(për më shumë se 50 % të importuesve), dhe për eksportet në më pak se dy ditë, ndërkohë që për vendet e tjera koha doganore e çlirimit të mallrave për eksport është 3-5 ditë.

Sipas sondazhit, eksportuesit janë shprehur për rënie të barrierave në formën e uljes së kërkesave për dokumentacion dhe leje e licensa(16 %) dhe dokumentacion shkresor (15 %), të cilat kanë rënë ndjeshëm që nga viti 2020. Kjo shpjegohet me disa nisma të integritimit rajonal, të cilat janë diskutuar dhe promovuar gjatë vitit 2021.

Pozitivisht konkluzioni i Barometrit se “Shqipëria nuk është në listën e vendeve që kërkon dokumentacion shkresor(Dogana shqiptare funksionojnë nëpërmjet sistemeve informatike dhe janë paper-less).

Nëse keni importuar gjatë 12 muajve të fundit cili është numri mesatar i ditëve për procedurat doganore?



Nëse keni eksportuar gjatë 12 muajve të fundit cili është numri mesatar i ditëve për procedurat doganore?



### Shërbejmë me profesionalizëm

Me përkushtim, profesionalizëm dhe efikasitet të gjitha strukturat doganore në pikat kufitare, punuan në funksion të rritjes së intesitetit të pasagjerëve dhe fluksit të turistëve gjatë këtij sezoni veror.

Rritja e fluksit të kalimit të pasagjerëve në hyrje dhe dalje ka krijuar rradhë në jo pak raste në të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar të vendit.

Për t'iu ardhur në ndihmë në temperaturat e larta të verës, punonjësit e Doganës kanë shpërndarë ujë të ftohtë për qytetarët.



### A e dini se? Përrjashtohen nga TVSH e importit Investime me vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 mln lekë

1- Makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit me vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 milionë (pesëqind milionë) lekë, të cilat nuk janë për shitje;

2- Personat e tatueshëm, të cilët do të importojnë makineri dhe pajisje për këtë rast duhet të paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dokumentet, si më poshtë vijon:

- një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;

- kopje të marrëveshjes me Këshillin e Ministrave, me anë të së cilës është miratuar kontrata e investimit, ku të jetë e specifikuar vlera e investimit e barabartë ose mbi 500 milionë (pesëqind milionë) lekë ; (nëse ka një marrëveshje të tillë), ose, në raste të investimeve tërësisht private, kopje të lejes/licencës/autorizimit (vetëm për kërkesën e parë);



- kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, ku të jetë e përcaktuar se vlera e investimit është e barabartë ose mbi 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë, si dhe kohëzgjatja e investimit;

- kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për vitin kur kryhen importet;
- të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive e të pajisjeve që do të importohen me kodet tarifore përkatëse dhe periudhën e instalimit;
- kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të ambienteve ku do të bëhet investimi;

- përshkrimin skematik dhe narrativ të skemës teknologjike për çdo element të saj.

- Deklaratë e personit të tatueshëm që makineria apo pajisja, për të cilën kërkohet përjashtimi, nuk është importuar për qëllime shitjeje